



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1302/Prot.

Tiranë, më 30/11 /2016

VENDIM

Nr. 93, datë 30/11 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Av. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1302 Prot., datë 18.11.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Prokurorisë së Përgjithshme/ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare".

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesave të datës 05.10.2016, ka kërkuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, t'i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni i disponueshëm në lidhje me:

Shkresën nr.prot. 085/16:

1. Në çfarë faze është procedimi penal për kallëzimin e bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me kallëzimin me nr.prot.731/10, datë 31.12.2013, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës (neni 248 i Kodit Penal), ndaj punonjësve të Komunës Mbrostar, Fier.
2. Kopje të vendimit të marrë nga prokuroria për kallëzimin e mësipërm.
3. Kopje të kallëzimit të bërë nga KLSH me nr.prot.731/10, datë 31.12.2013.
4. A i është komunikuar KLSH-së vendimi i marrë nga Prokuroria për kallëzimin e mësipërm dhe në cilën datë.

Shkresën nr.prot. 086/16:

1. Në çfarë faze është procedimi penal për kallëzimin e bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me kallëzimin me nr.prot.243/7, datë 13.05.2013, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës (neni 248 i Kodit Penal), ndaj punonjësve të Komunës Levan, Fier.
2. Kopje të vendimit të marrë nga prokuroria për kallëzimin e mësipërm.
3. Kopje të kallëzimit të bërë nga KLSH me nr.prot.243/7, datë 13.05.2013.

4. *A i është komunikuar KLSH-së vendimi i marrë nga Prokuroria për kallëzimin e mësipërm dhe në cilën datë.*

Shkresën nr.prot. 087/16:

1. *Në çfarë faze është procedimi penal për kallëzimet e bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me kallëzimin me nr.prot.245/9, datë 24.07.2013 dhe me kallëzimin nr.prot.245/10, datë 24.07.2013 për veprën penale të shpërdorimit të detyrës (neni 248 i Kodit Penal), ndaj punonjësve të Bashkisë Fier.*
2. *Kopje të vendimeve të marrë nga prokuroria për kallëzimin e mësipërm.*
3. *Kopje të kallëzimit të bërë nga KLSH me nr.prot.245/9, datë 24.07.2013 dhe kallëzimit me nr.prot.245/10, datë 24.07.2013.*
4. *A i është komunikuar KLSH-së vendimi i marrë nga Prokuroria për kallëzimet e mësipërme dhe në cilën datë.*

Me shkresën nr. 9990/1 Prot., datë 24.10.2016, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier i ka kthyer përgjigje kërkuesit duke i sqaruar ndër të tjerat se: *“Në lidhje me kallëzimin e dt.13.05.2013, është regjistruar procedimi penal Nr.297, datë 15.05.2013, i cili është pushuar në dt.22.05.2015. Në lidhje me kallëzimin dt.24.07.2013 është regjistruar procedimi penal Nr.473, datë 31.07.2013 i cili është pushuar në dt.26.06.2015. Në lidhje me kallëzimin dt.31.12.2013 është regjistruar procedimi penal Nr.19, datë 07.01.2014 i gjykuar në dt.17.02.2015. Për sa i përket vënies në dispozicion të këtyre akteve, nuk mund të vendosen në dispozicion pasi vetëm palët (kallëzuesi dhe i kallëzuari) mund të pajisen me kopje të akteve të procedimeve penale.”*

Pas kthimit të përgjigjes nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, ankuesi pretendon se: *“Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier nuk ka vendosur në dispozicion kopje të vendimeve të marra nga prokuroria si dhe kopje të kallëzimeve të bëra nga KLSH, të cilat janë objekt i kërkesave, me arsyetimin se vetëm palët (kallëzuesi dhe i kallëzuari) mund të pajisen me kopje të akteve të procedimeve penale...”. Në këto kushte ankuesi Qendra “Res Publica” kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.*

Pas shqyrtimit të ankesës si dhe konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Qendra “Res Publica” është i regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dhe si i tillë ai administrohet prej kësaj të fundit. Ekzistenca e dokumentacionit pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Për sa më lart informacioni i kërkuar në pikën 2 të kërkesave me nr.085/16, nr.086/16 dhe nr.087/16, datë 05.10.2016, mund të bëhet publik në përputhje me nenet 287, 328 dhe 329 (kjo e fundit, dispozitë e cila parashikon drejtëpërdrejtë palët të cilat kanë interes të ligjshëm për marrjen e këtij informacioni në mënyrë të plotë) të Ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 17 pika 6 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe në respektim të neneve 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe Udhëzimit

nr.15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor” (marrë si analogji edhe për këtë rast).

Gjithashtu edhe informacioni i kërkuar në pikën 3 të kërkesave me nr.085/16; nr.086/16 dhe nr.087/16, mund të bëhet publik në përputhje me nenin 17, pika 6 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe në respektim të neneve 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Nën këto argumente ligjorë, nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër duhet t’i vendoset në dispozicion ankuesit Qendrës “Res Publica”. Personat përgjegjës për dhënien e informacionit të kërkuar duhet të bëjnë anonimizimin e të dhënave në përputhje me nenet e sipërcituara.

Ndërsa, lidhur me pikën 4 të kërkesës me nr.085/16; nr.086/16 dhe nr.087/16, datë 05.10.2016, rezulton se ky lloj informacioni nuk përmban elementë të dispozitave të lartpërmendura dhe si i tillë ai i duhet vënë në dispozicion ankuesit.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” ndaj Autoritetit Publik/ Prokurorisë së Përgjithshme/ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Res Publica” , Nr. 1302 Prot., datë 18.11.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Prokurorisë së Përgjithshme/ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Prokurorisë së Përgjithshme, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, në pikën 2 dhe 3 të kërkesave me nr.085/16; nr.086/16 dhe nr.087/16, datë 05.10.2016, në përputhje me nenet 287, 328 dhe 329 të Ligjit nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 17 pika 6 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe në respektim të neneve 5, 6, 7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, brenda datës 7.12.2016.
3. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Prokurorisë së Përgjithshme, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në pikën 4 të kërkesave me nr.085/16; nr.086/16 dhe nr.087/16, datë 05.10.2016, në formën e kërkuar, brenda datës 7.12.2016.

4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
5. Ky vendim u dha sot në datë 30. 11 .2016.

